

STATUT DHE AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR N.L ENERGY SHPK

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe të Aktit të Themelimit të Shoqërisë **N.L ENERGY SHPK** ("Shoqëria"), veprimtaria e saj do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti:

Neni 1

Emërtimi

- 1.1 Emërtimi i Shoqërisë është **N.L ENERGY** ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa SHPK, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- 1.2 **N.L ENERGY SHPK** do të ketë shenjat e veta dalluese dhe vulën e saj, e cila miratohet nga Ortaku i vetëm i Shoqërisë.

Neni 2

Forma ligjore

- 2.1 Shoqëria është një person juridik shqiptar, e cila ka formën juridike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, dhe e zhvillon veprimtarinë e vet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil, Ligjinr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe Ligjinr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar.

Neni 3

Objekti

- 3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:
 - Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike së prodhuar nga burime të rinovueshme nga burimet diellore, të erës apo hidrike.
 - Studimi, projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i paneleve dhe centraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe infrastrukturës së impianteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike nga burime të rinovueshme nëpërmjet paneleve dhe parqeve fotovoltaike, hidrike dhe eolike.
 - Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë elektrike.
 - Ofrimi i asistencës teknike, riparimit dhe mirëmbajtjes së aparaturave, impianteve dhe linjave për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.
 - Ndërtimi, mirëmbajtja dhe operimi i linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.
 - Ndërtimi i linjave për prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemeve periferike për burimet e rinovueshme, ndërtimi dhe aktivitete të tregtimit të gjitha format e materialeve të ndërtimit.
 - Ndërmjetësim me komision për blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve të burimeve të energjisë së rinovueshme, parqeve diellore, turbinave me erë dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për tjetër.
 - Marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemeve periferike për burimet erinovueshme.
 - Shërbimet e komisionit financiar të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta.

- Importi dhe eksporti me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit të shoqërisë dhe të lejuara nga legjislacioni në fuqi për shoqërinë.
- Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar në Republikën e Shqipërisë i cili është në funksion ose jo të objektit të kësaj shoqërie.

3.2 Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore, të zbatueshme me vendim të ortakut të vetëm/Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.
- 4.2 Vendosija e mëpasshme e një kufizimi në kohë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 5

Selia

- 5.1 Selia e Shoqërisë **N.L ENERGY SHPK** do të jetë në Shkoder, në adresën: Hajmel Lagja Qender, ndertesa dy kateshe, me nr pasurie 402, zona kadastrale 1920 4029.
- 5.2 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e Shoqërisë, si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 6

Kapitali themeltar

- 6.1 1) Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është në vlerën **200,000(dyqindmije)** Lekë e përbërë nga dy(2)kuota.
- 2) Kuotat janë të shpërndara ndërmjet ortakëve si në vijim:
- a. **Z. Lazer Letja**, shtetas shqiptar, lindur më 06.05.1991, i cili zotëron 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë të përgjithshme 100,000(njeqindmije) Lekë.
- b. **Z. Ernest Rranzi**, shtetas shqiptar, lindur më 03.10.1981, i cili zotëron 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlerë të përgjithshme 100,000(njeqindmije) Lekë.
- 3) Për efekt të këtij Statuti, si kontribut i Ortakëve të Shoqërisë njihet **kontributi në para**.
- 4) Kapitali i dhënë nga Ortakët Themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshem dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 7.1 1) Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë, përmes nënshkrimit të kontributeve në para.
- 2) Rritja e kapitalit themeltar të shoqërisë nuk është e kufizuar.
- 3) Shoqëria mund të rrisë kapitalin themeltar, ose mund ta zvogëlojë atë, por gjithnjë jo nën kufirin e 100.00 lekë-ve, sipas kërkesave të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Shtimi dhe paksimi i kapitalit bëhet me vendim të Ortakëve të Shoqërisë dhe sipas kërkesave të ligjit.

Neni 8

Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 8.1 Kuota/t e kapitalit janë të transferueshme me pelqimin me shkrim të Ortakut/ëve të tjerë të Shoqërisë. Transferimi i kuotës/ave të kapitalit bëhet vetëm me akt noterial. Pjesa/ët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë ligjore, trashëgimnie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve dhe pasardhësve.
- 8.2 Në rast vdekjeje të secilit prej Ortakëve të Shoqërisë, pjesa e kapitalit themeltar që ai disponon i kalon trashëgimtareve të tij. Trashëgimtari hyn në shoqëri me të gjitha të

drejtat e detyrimit perkatese te ortakut. Ne rast se asnjeri nga trashegimtarete nuk pranon te punojë ne shoqeri, atherë ata jane të detyruar të shesin pjesën e kuotave te kapitalit që trashegojne në favor të Ortakëve te Shoqerise. Pas shitjes se kuotave, trashegimtarete marrin te gjitha fitimet qe iu takojnë sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themelor nga ortaku i vdekur.

- 8.3 Transferimi i kuotave te kapitalit bëhet sipas kërkesave të ligjit dhurimit;
 - a) çdo mënyrë tjetër të parashikuar më ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët.
- 8.3 Miratimi për transferimin e kuotës bëhet nga me Vendim Ortakut të vetëm të Shoqërisë/Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

Neni 9

Organi vendimmarrës

- 9.1 Organet drejtuese te Shoqerise jane:
 - a)Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqerise.
 - b)Administratori i Shoqerise.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve organi vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit në përputhje me dispozitat ligjore.
- 9.3 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) ndryshimet e Statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ve;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesit/ve dhe te ekspertit/ëve kontabël;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjën "c" e "d" të pikës 9.3 të Statutit;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g)miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - gj) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - j) riorganizimin, falimentimin, likuidimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
 - l)çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti dhe të cilat nuk janë kompetencë e administratorit/ëve.
- 9.4 Çdo ndryshim Statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.
- 9.5 Të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme do të ushtrohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, për sa kohë që kapitali themeltar do të zotërohet vetëm nga një ortak.

Neni 10

Mbledhjet dhe mënyra e thirrjes se mbledhjeve

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme mund te organizoje mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Ne të gjithë rastet, mbledhja mund te thirret nga secili prej ortakëve të Shoqërisë i cili do të jetë përgjegjës per njoftimin e dates, vendit dhe ores të mbledhjes Si dhe të rendit te ditës shoqëruar nga materialet e nevojshme per tu shqyrtuar para mbledhjes nga ortaku/ët e tjere.

- 10.2 Ortaku i ciii thërret mbledhjen e Shoqerise do të njoftojë Ortakët e Shoqerise per vendin, datën dhe orën e mbledhjes jo me vonë se 30 ditë para dates se caktuar të mbledhjes. Rendi i dites dhe materialet shoqeruese do të njoftohen Jo me vonë se 10 ditë para dates se mbledhjes. Per efekt të ketij Statuti, njoftimi me email do të njihet si formë e vlefshme njoftimi.
- 10.3 Mbledhjet e Asamblesë do te mund te mbahen vecse flizikisht, edhe permes perdorimit te mjeteve të komunikimit elektronik (online).
- 10.4 Mbledhjet e zakonshme thirren te pakten dy here ne vit, pas mbylljes së vitit financiar dhe kur aprovohet programi i veprimtarisë per vitin e ardhshëm.
- 10.5 Mbledhjet e zakonshme mund të thirren edhe kur secili prej ortakëve e quan të përshtatshme mbledhjen e ortakëve per të adresuar kërkesat e shoqerise.
- 10.6 Secili prej Ortakëve te Shoqerise merr pjesë ne mbledhje personalisht dhe perfaqesimi me prokure nuk lejohet.
- 10.7 Vendimet e Shoqerise do të merren unanimisht.
- 10.8 Vendimet e Ortakëve të Shoqerise duhet të nënshkruhen nga Administratori i shoqerise, dhe nga Ortakët e Shoqerise.

Neni 11

Administrimi

- 11.1 Organi administrativ i shoqërise eshte Administratori i shoqerisë. Administrator i shoqerise "N.L ENERGY" SH.P.K, per **5 vitet** e para, do te jetë:
Z. Lazer Letja, me nr personal J10506065W shtetas shqiptar, lindur në Hajmel, Shkoder më 06.05.1991, dhe banues në Shkoder.
- 11.2 Administratori ka nje mandat 5 vjecar, pervec rasteve te doreheqjes se tij nga detyra e administratorit apo revokimit të tij nga detyra dhe emërimin e nje administratori të ri me vendim të Ortakëve të Shoqerise.
- 11.3 Administratori i shoqërise perfaqeson Shoqerine në marrëdhënie me subjekte te treta fizike ose juridike, publike ose private, vendase ose të huaja. Ne këtë kuadër, Administratori mban dokumentacionin e Shoqerise dhe siguron rregullsine e tij dhe te mbledhjeve të Shoqerise.
- 11.4 Administratori i Shoqërise është mbajtësi i autorizuar i vulës së Shoqerise.

Neni 12

Përgjegjësitë e Administratorit

- 12.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit "Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare" Administratori detyrohet:
- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë së Shoqërisë në mjedisin tregtar dhe përkatës;
 - të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në Statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të Shoqërisë;
 - të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm, siç kërkohet në dispozitat ligjore të zbatueshme.

- të sigurojë zbatimin e legjislacionit në fuqi për shoqëritë.

Neni 13 **Asambleja e Ortakëve**

13.1 Asambleja e Ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
- d. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat ucl dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

13.2 Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët e Shoqërisë regjistrohen në një regjistër vendimesh që mbahet nga Administratori dhe të dhenat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në vecanti, për pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- b. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c. investime; dhe
- d. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 14 **Viti Financiar**

- 13.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor të vitit përkatës.

Neni 15 **Kontrolli Financiar**

- 14.1 Shoqëria mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar për kryerjen e kontrollit financiar të veprimtarisë së saj.

Neni 16 **Fitimi I Shoqërisë**

- 15.1 Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga Ortakët e Shoqërisë.
- 15.2 Një pjesë e këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

Neni 17 **Kontrolli financiar I Shoqërisë**

- 17.1 Kontrolli financiar I shoqërisë kryhet nga një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar

ose të emëruar nga Ortakët e Shoqërise me nje afat prej tre vitesh financiare të njepasnjëshme me mundësi riemërimi.

Neni 18

Dokumentat financiare te Shoqerise

- 18.1 Llogarite vjetore, inventarët, raporti mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët apo ekspertet kontabël miratohet nga Ortakët e Shoqërise. Miratimi i dokumentave financiare vjetore bëhet brenda një afati 3-mujor, mbas dates se shlyerjes së vitit financiar.

Neni 19

Ndarja e fitimit të Shoqerise

- 19.1 Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe vërtetimit të ekzistencës së fitimit Ortakët e Shoqërise, pasi kane likuiduar të gjithë detyrimet ligj ore financiare, vendosin për ndarjen e fitimeve.

Neni 20

Marrëdhëniet e punësimit brenda Shoqërise

- 20.1 Marrëdhëniet e punësimit brenda shoqërise rregullohen nepërmjet kontratës së punësimit që lidhet midis paleve në përputhje me ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 21

Marrëdhëniet kontraktore të Shoqerise

- 21.1 Shoqëria mund të lidhë kontrata me sektorë shtetëror drejtpërdrejt në tregun e lirë si dhe me persona juridik ose fizik, vendas ose të huaj.
21.2 Në veprimet kontraktore shoqëria përfaqësohet nga administratori i shoqërise.
21.3 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërine.

Neni 22

Prishja e Shoqërisë

- 22.1 Shoqëria mund të prishet me vendim të Ortakëve të Shoqërise ose kur ka shkaqe të tjera që con në prishje të parakoshme të shoqërise.
22.2 Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likuidator të cilët ndjekin operacionet e likuidimit den në fund dhe i paraqesin Ortakëve të Shoqërise rezultatet përfundimtare të likuidimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
22.3 Në përfundim të detyres së tyre, Ortakët e Shoqërisë vendosin për heqjen e mandatit të likuiduesve.
22.4 Ortakët e Shoqërise marrin përsipër për t'i shlyer të gjithë detyrimet që dalin nga akti i likuidimit me kapitalin e derdhur prej tij në kapitalin themelor të shoqërisë.

Neni 23

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimindarja

- 23.1 Shoqëria mund të ndahet dhe bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe në këtë Statut.

Neni 24

Mosmarrëveshjet

- 18.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti dhe funksionimin e Shoqërisë, palët i drejtohen legjislacionit shqiptar dhe synojnë zgjidhjen me mirëkuptim. Në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder.

Neni 25

Legjislacioni I zbatueshëm

25.1 Cështje të tjera, të patrajtuara në këtë statut do të trajtohen sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, konkretisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil Shqiptar dhe akte të tjera ligjore dhe nenligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 26

Vula e Shoqërisë

26.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj e cila do të mbahet nga Administratori i Shoqërisë.

Neni 27

Dispozita Finale

27.1 Statuti është hartuar me vullnetin e lire dhe të plote të Ortakëve Themelues dhe është nënshkruar prej tyre.

27.2 Statuti hartohet në katër për t'iu shpërndarë organeve kompetente dhe ortakëve, si dhe një kopje mbetet në dokumentacionin hazë të shoqërisë.

Shkoder më 17.02.2023

ORTAKET THEMELUES

Z.Lazer Letja



Z. Ernest Rranzi

